



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1874/1 Prot.

Tiranë, më 21.07 2023

V E N D I M

Nr. 87 datë 21.07 2023

PËR
DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E ANALITIKE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së neni 25, gërma d), në Vendimin e Senatit nr.06, datë 27.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative, analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.07, datë 01.02.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023 në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, në shkresat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 720/1 prot., datë 04.07.2023 “Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”, me nr. 721/1 prot., datë 04.07.2023 “Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”, me nr. 722/1 prot., datë 04.07.2023 “Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”, me nr. 723/1 prot., datë 04.07.2023 “Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”, si dhe në shkresën me nr. 724/1 prot., datë 04.07.2023 “Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 21.07.2023,

V E N D O S I:

1. Miratimin dhe ndryshimin e strukturës organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si më poshtë:
 - **Z. Genti Petraq Pano**, Zv/Dekan në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit, me gradë shkencore “Doktor” kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 29.05.2023 e në vazhdim.
 - **Znj. Oltiana Mihal Petri**, Drejtuese e Departamentit të Shkencave Biomjekësore dhe Humane, FSHR, me gradë shkencore “Doktor” kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 29.05.2023 e në vazhdim.
 - **Znj. Genta Astrit Nallbani**, me gradë shkencore “Doktor” pranë Departamentit të Kineziologjisë, FSHR, kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 29.05.2023 e në vazhdim.

- **Znj. Rigerta Ismail Selenica**, me gradë shkencore “Doktor” pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, FSHL, kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 01.06.2023 e në vazhdim.
 - **Znj. Najada Arian Quka**, me gradë shkencore “Doktor” pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, FSHL, kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” nga data 01.06.2023 e në vazhdim.
2. Efektet financiare shtrihen nga data e përfitimit të titullit akademik dhe në zbatim të VKM me nr.243, datë 20.04.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Lidhja nr.1.
 3. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA



Konceptoi Drejtore: L. Shehu

Numri i kopjeve origjinale: 3 (tre)